

NJË FLOTË GJITHNJË E MË SHUMË GREEN: ADRIA FERRIES PARAQET PAJISJET SCRUBBERS

Shoqëria e lundrimit Adria Ferries, e para në portin e Ankonës, si përgjigje ndaj normativës Low Sulphur Cap 2020 në fuqi që nga 1 janari i ardhshëm dhe paraprakisht në krahasim me afatin e përcaktuar sipas ligjit, ka zgjedhur të rinovojë sistemet e shkarkimit të flotës së saj me qëllim që të kontribuojë konkretisht në mbrojtjen e burimeve natyrore.

Normativa Imo, në fakt, parashikon që anijet e çdo flamuri duhet të përdorin lëndë djegëse me përmbajtje sqfuri në masë jo më të lartë se 0.5%, në dallim nga kufiri i deritanishëm i toleruar prej 3.5%, me qëllim që të zvogëlohet ndotja atmosferike e shkaktuar nga emetimet e anijeve.

Me këtë rast, me qëllim që të përmbushen kërkesat e duhura deri në fund të vitit 2020, Normativa ka vënë në dispozicion të shoqërive armatore opsionet e mëposhtme:

1. përdorimin e karburantit me përmbajtje të ulët sqfuri (0,5%) ose naftë marine (MGO)
2. përdorimin e gazrave alternativ siç është gasi i lëngshëm (LNG) ose bio-karburantet pa sqfur.
3. pajisjen e anijeve me impiante të pastrimit të gazeve të shkarkimit që quhen scrubbers, të cilët lejojnë funksionimin me lëndë djegëse me përmbajtje të lartë sqfuri (HSFO).

Duke respektuar misionin e saj, Shoqëria e lundrimit ka perfeksionuar flotën e vet duke pajisur të dy anijet, AF Marina dhe AF Claudia, me aparatura për larjen e gazeve të shkarkimit, që quhen scrubbers, e që janë në gjendje të zvogëlojnë në mënyrë drastike, nëpërmjet ujit të detit, sasinë e sqfurit të pranishëm në tymrat e prodhuar.

Avantazhet që lidhen me përdorimin e pajisjeve Scrubber në krahasim me alternativat e propozuara nga Normativa janë të shumta:

- të zvogëlojë në mënyrë të konsiderueshme grimcat e ndotësve atmosferikë siç janë hidrokarburet policiklikë aromatikë (PAHS) që janë të dëmshme për mjedisin;
- të eliminojë një pjesë të madhe të blözës që del nga oxhakët dhe që ndikon negativisht në cilësinë e ajrit dhe rrjedhimisht në shëndetin e njeriut;
- të mos shtojë lëndë ndotëse të rrezikshme në ujë;
- të monitorojë parametrat e PH-së, turbullirën dhe sasinë e PAH-së së pranishme në ujërat në dalje;

Nënkuptohe, pra, se me anën e përdorimit të aparaturave për eliminimin e emetimeve të dëmshme, siç janë Scrubbers, është e mundur të zvogëlojnë ndjeshëm substancat e rrezikshme të prodhuara nga gazrat e shkarkimit; jo vetëm sqfurin, por edhe ndotësit atmosferikë dhe materialet e tjera që përndryshe do të shpërndaheshin në ajër.

Zgjedhja e këtyre teknologjive i garanton Adria Ferries jo vetëm respektimin e normativave, por edhe të vlerave thelbësore të vizionit të ndërmarrjes: për të qenë pararojë dhe për të pasur qëndrueshmëri. Shoqëria, në fakt, gjithmonë synon një administrim të përgjegjshëm të aktiviteteve të saj, të aftë për të siguruar zhvillimin e zgjidhjeve novatore që të kontribuojnë në ruajtjen e ambientit dhe të formave të tij të jetës.

